VENDIM
Nr.434, datë 26.5.2010

PËR KALIMIN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE, TË OBJEKTIT NR.35, NË KOMANDËN E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe të nenit 901 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përdorim, pa shpërblim, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për Fakultetin e Shkencave Sociale, të objektit nr.35, në Universitetin Ushtarak "Skënderbej", pjesë e pronës nr.12 "Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes", pronë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim zhvillimin e programit mësimor për periudhën 12.10.2009-30.9.2010.

2. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Fakultetit të Shkencave Sociale u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojnë atë ose ta japin në përdorim te të tretët.

3. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës të lidhin kontratën e huapërdorjes, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha